

**RELACION**  
**PËR PROJEKTLIGJIN**

**PËR**  
**NJË NDRYSHIM DHE NJË SHITESË NË LIGJIN NR. 10316, DATË 16.9.2010 “PËR**  
**DISA SHITESA NË LIGJIN NR.7764, DATË 02.11.1993 “PËR INVESTIMET E**  
**HUAJA””**

**I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË**  
**ARRIHEN**

Ky projekt ka si qëllim përmirësimin e kuadrit ligjor lidhur me investimet e huaja dhe garantimin e tyre në një nivel më të lartë.

Kjo nismë synon t'i ofrojë me tepër garanci dhe siguri juridike investitorëve të huaj, të cilët investojnë në Shqipërisë, veçanërisht për sa i përket ofrimit të garancive për çështjet e pronësisë dhe garantimit të titujve të pronësisë përballë palëve të treta. Kjo pasi çështjet e pronësisë apo pasiguria juridike, ndikojnë negativisht në investimet aktuale apo në investimet e pritshme.

Investitorët vuajnë pasojat e kësaj shtese për shkak të pasigurive juridike që paraqesin titujt e pronësisë dhe nevojës për garanci shtesë, ndërsa nga ana tjetër kjo shtese rëndon mbi ekonominë vendase.

Rrjedhimisht kjo nismë synon t'i mundësojë investitorëve strategjike dhënien e garancive shtese nga shteti, nëpërmjet mbrojtjes së posaçme shtetërore për ato situata që shfaqin pasiguri juridike për këta investitorë.

Në këtë mënyrë është e mundur të shtohet niveli i besueshmërisë si dhe konsolidohet klima e biznesit në vend, çka mund të përkthehet me një shtim të investimeve në nivel afat shkurtër.

Për sa me sipër është hartuar ky projektligj

**II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN**  
**POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN**  
**ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE**

Projektligji nuk është parashikuar në programin analitik të MZHETTS për vitin 2017.

**III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË,**  
**PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Një pjesë e investimeve të huaja të parashikuara për t'u realizuar në vendin, disa herë janë shtyrë në kohë apo në raste të tjera nuk janë realizuar për shkak se ato janë përballur me një situatë pasigurie juridike, e cila ka efekte negative si për shtetin dhe investitorët. Kjo situatë vërehet shpesh në lidhje me çështjet e pronësisë dhe pasigurinë që sjellin për investimet paqartësitë e titujve të pronësisë.

Pasiguria juridike e titujve te pronësisë është shtuar edhe me shume nisur edhe nga gjendja e sistemit gjyqësor shqiptar.

Për t'ju përgjigjur kësaj problematike Kuvendi i Shqipërisë ne vitin 2010 miratoi disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr.7764, date 02.11.1993, me qellim dhënien e një mbrojtjeje te posaçme për investitorët e huaj. Konkretisht përfshirja e mekanizmit te mbrojtjes se posaçme shtetërore ne vitin 2010 synonte mbrojtjen e investimeve te huaja ne rastet kur, për shkak te konflikteve gjyqësore me pale te treta private pengohet realizimi i investimit. Kjo mbrojtje parashikonte zëvendësimin me te drejta te plota te investitorët e huaj nga ana e shtetit shqiptar ne një konflikt me pale te treta. Sidoqoftë një nga kufizimet e këtij ligji është se kjo mbrojtje e posaçme shtetërore ishte e kufizuar ne kohe deri me date 31.12.2014.

Për këtë qellim, veçanërisht për garantimin e titujve te pronësisë mbi te cilat këto investitorë kane kryer investime është e nevojshme ofrimi i garancive dhe mbrojtjeve te përshtatshme, me anën e mbrojtjes se posaçme shtetërore.

Për sa me sipër është hartuar ky projektligj.

#### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Projektligji i propozuar është hartuar ne mbështetje te nenit 81, pika 1 dhe 100 te Kushtetutës.

#### **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)**

Nuk ka

#### **VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT**

Projektligji është i ndarë në 2 nene.

Në nenin 1 ne piken e parë është parashikuar zgjatja e afatit te mbrojtjes se posaçme deri me datë "31 Dhjetor 2018".

Ne piken e dyte është parashikuar shtimi i një paragrafi me kete përmbajtje:

"Mbrojtje të posaçme shtetërore sipas parashikimeve të neneve 8/b, pikave 1 dhe 2; 8/d dhe 8/dh të këtij ligji, përfitojnë automatikisht dhe pa patur nevojën e ndjekjes se ndonjë procedure apo marrjes se ndonjë vendimi tjetër, edhe investitorët/investimet strategjike, procedurë e veçantë që kanë marrë këtë status në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 55/2015, "Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë". Këshilli i Ministrave, përcakton kufijtë dhe tagrat e zëvendësimit te palëve, ne përputhje me nenin 8/b te këtij ligji.

#### **VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT**

---

Relacion shpjegues për projektligjin "Për disa shtesa ne ligjin nr.7764, date 02.11.1993 "Per investimet e huaja"

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohen te gjitha institucionet.

#### **VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT**

Projektligji është hartuar nga ana e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes

#### **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Ky projektligj nuk shoqërohet me shpenzime shtesë financiare në buxhetin e shtetit.

**MINISTRI**

**MILVA EKONOMI**